



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-127

Prishtinë, më 30 shtator 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 SHTATOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 23 shtator 2013,
2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës plenare,
3. Shqyrtimi i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 shtator 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 shtator 2013.

2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës plenare:

Për vazhdimin e seancave plenare diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e plota të të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 2 tetor 2013, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE,
2. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102,
3. Votimi i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht,
4. Votimi i raportit i të Komisionit për Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi Gjinore,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit.

3. Shqyrtimi i kërkesave:

1. Njoftimi për ndërrimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komuniteteve të tjera, që nuk janë shumicë, sipas marrëveshjes së tyre dhe të vendimit të Kuvendit, nr. 04-V-590

Kryesia u njoftua me marrëveshjen e Grupit Parlamentar “6+” dhe me vendimin e Kuvendit se pas përfundimit të mandatit të nënkryetarit të Kuvendit, z. Rasim Demiri, më 31 tetor 2013, për gjashtë muajt e ardhshëm zgjidhet deputeti Albert Kinolli, prej datës 1 nëntor 2013 deri më 30 prill 2014, nga komuniteti rom, ndërsa pas përfundimit të mandatit të z. Albert Kinolli, nënkryetar i Kuvendit zgjidhet z. Etem Arifi, prej datës 1 maj 2014 deri më 30 shtator 2014, nga radhët e komunitetit ashkali.

2. Kërkesa e Zyrës së Presidentes për hapjen e një pikëkalimi me vetura nga ana e përparme e ndërtesës së Kuvendit

Sekretari i Kuvendit e njoftoi Kryesinë lidhur me kërkesën e Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës për hapjen e një porte për hyrje-dalje me vetura nga ana e majtë e pjesës së përparme të ndërtesës së Kuvendit.

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimet e plota të të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, nuk e mbështeti kërkesën e Zyrës së Presidentes.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale